



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 160 Prot

Tiranë, më 18.01.2021

Nr. 1466 Dosje

**U R D H Ë R**

**PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar :** QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Altin Vako , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 925 (31134-03834-80-2020) Regj.Them, të lëshuar më datë 30.09.2020 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr. 1466, Datë 28.12.2020 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqëria “HEC LLENGE” Sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 195, datë 25.06.2019.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1839 Prot, Datë 28.12.2020 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 925 (31134-03834-80-2020) Regj.Them, Datë 30.09.2020, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOJ**

Se debitori Shoqëria “HEC LLENGE” Sh.p.k, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet te debitorit Shoqëria “HEC LLENGE” Sh.p.k, në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



Për sa më sipër, në referim të Ligjit Nr. 26/2019, Datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, si dhe Nenit 39 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”,

### URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
  - a) Shoqëria “HEC LLENGE” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: L22125012H
  - Dhe
  - b) Z. Harallambe Gjoka (atësia: Dhimitraqi, i datëlindjes: 24.07.1983) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “HEC LLENGE” Sh.p.k
  
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
  - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
  - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
  - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
  
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
  
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
  
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbartimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri
  
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**ALTIN VAKO**

